



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 248, datë 20.12.2018

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT NR. 205, DATË 05.10.2018 “PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË BROKERIMIT
“DEVON” SH.A.”.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 113, të Kodit të Procedurës Administrative, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Bordi i AMF-së me anë të vendimit nr. 205, datë 05.10.2018 “Për marrjen e masës administrative ndaj shoqërisë së brokerimit “Devon”sh.a.”, ka vendosur një gjobë në masën 800,000 lekë. Masa e marrë nga Autoriteti është vendosur për shkakun se shoqëria e brokerimit nuk ka depozituar pranë Autoritetit pasqyrën financiare të vitit 2017 dhe raportimin e pasqyrave financiare të 6-mujorit të parë të vitit 2018, në kundërshtim me nenin 217, pika 3 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të nenit 3, pika 3, të Rregullores nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, e ndryshuar.

Shoqëria “Devon” sh.a., me shkresën nr. 3390/1 prot., datë 15.10.2018, ka depozituar në Autoritet kërkesën për rivlerësim të vendimit të Bordit nr. 205, datë 05.10.2018, pasi zbatimi i këtij vendimi për pagesën e kësaj gjobë do të çojë në dorëzim të licencës nga ana e tyre pasi janë në pamundësi për ta paguar.

Shkaqet e parashtruara në kërkesë konsistojnë në pretendimet se kanë qënë në komunikim të vazhdueshëm me telefon dhe e-mail me specialistin përkatës të AMF-së për plotësimin sa më saktë të pasqyrave financiare të 6-mujorit të parë të vitit 2018. U dorëzuan evidencat statistikore

të 6-mujorit ndërsa për pasqyrën financiare u bë me dije specialisti se ekonomisti që plotëson formularin ishte me pushime verore jashtë vendit dhe sapo të vinte do të dorëzohej.

Zj. Çarçani, informon se ka një eksperiencë prej 9 vitesh në tregun e sigurimeve dhe për ushtrimin e veprimtarisë së saj, të brokerit nuk ka marrë asnjë masë administrative.

Pretendimi tjetër konsiston në faktin se procedimi administrativ është marrë pa krijuar mundësinë e njoftimit dhe të dëgjimit për të dhënë shpjegimet e duhura.

Situata financiare e shoqërisë së brokerimit nuk i kalon vlerën e të ardhurave deri në 5,000,000 lekë dhe fitimi neto duke hequr shpenzimet është në nivele shumë të ulta. Referuar bilancit të 6-mujorit të parë të vitit 2018, si dhe bilancit të vitit 2017, rezulton se të ardhurat mesatare mujore nga aktiviteti i ndërmjetësimit të kësaj shoqërie janë rreth 500,000 lekë.

Mos depozitimi pranë Autoritetit të pasqyrave financiare të vitit 2017 dhe raportimin e pasqyrave financiare të 6-mujorit të parë të vitit 2018, bie në kundërshtim me nenin 217, pika 3 të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të nenit 3, pika 3, të Rregullores nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, e ndryshuar.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Në vendimin e Bordit nr. 205, datë 05.10.2018 “Për marrjen e masës administrative ndaj shoqërisë së brokerimit “Devon”sh.a.”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:**

1.1 Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Bazuar në pikën 8, të nenit 211, të Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të pezullojë licencën për një periudhë 3-mujore nga marrja e këtij vendimi.”

- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI